

SHQIP sh.p.k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 18

SHQIP shpk
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	179,879	553,494
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	15,977,813	16,802,269
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	1,080,000	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	639,081	639,081
Shpenzime të shtyra	8	206,339	403,064
Total aktive afatshkurtra		18,083,112	18,397,908
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	1,982,912	2,539,584
Total aktive afatgjata		1,982,912	2,539,584
Total aktive		20,066,024	20,937,492
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	10	33,558,067	31,072,966
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	11	7,452,714	15,303,240
Detyrime tatimore	12	79,672	137,564
Të tjera detyrime	13	6,169,210	806,219
Total detyrime afatshkurtra		47,259,663	47,319,989
Detyrime afatgjata			
Total detyrime afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		47,259,663	47,319,989
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		100,000	100,000
Rezerva ligjore		20,000	20,000
Fitime/Humbje të mbartura		(26,502,497)	(28,441,008)
Fitimi/Humbje të ushtrimit		(811,142)	1,938,511
Total i kapitalit	14	(27,193,639)	(26,382,497)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		20,066,024	20,937,492

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15	6,277,408	23,853,915
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	16	131,814	80,676
Lenda e pare, materiale dhe shpenzime	17	(1,748,007)	(19,316,288)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime		-	(9,955,240)
2) Të tjera shpenzime	18	(1,748,007)	(9,361,048)
Shpenzime të personelit	19	(4,915,376)	(12,191,893)
1) Paga dhe shpërblime		(4,282,232)	(10,509,496)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(633,144)	(1,682,397)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	20	(556,671)	(883,787)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit		-	(1,368)
Të ardhura të tjera	21	16	10,400,050
Të ardhura të tjera		16	10,400,050
Shpenzime financiare	22	(326)	(2,794)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(326)	(1,655)
2) Shpenzime të tjera financiare		-	(1,139)
Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		(811,142)	1,938,511
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
Fitimi/humbja e vitit	23	(811,142)	1,938,511
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(811,142)	1,938,511

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHQIP shpk

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitime të Pashpërdara	Fitim/Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2016	100,000	20,000	(21,311,002)	(7,130,008)	(28,321,008)
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	-	1,938,511	1,938,511
Tranferime në fitim/humbje të mbartura	-	-	(7,130,008)	7,130,008	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	100,000	20,000	(28,441,008)	1,938,511	(26,382,497)
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	-	(811,142)	(811,142)
Tranferime në fitim/humbje të mbartura	-	-	1,938,511	(1,938,511)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	100,000	20,000	(26,502,497)	(811,142)	(27,193,639)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori i SHQIP sh.p.k më 27/03/2018 dhe janë firmosur si më poshtë.


Vjollca Hoxha
Administrator




Mazars shpk

Hartues i Pasqyrave Financiare


Rr. Ervin Çorriq, Pat. Brijakët,
No.5, 1000, Tiranë, Albania
Phone: +355 42 27 30 15
www.mazars.al, info@mazars.al

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	(811,142)	1,938,511
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	131,814	79,537
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	556,671	883,787
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	128,821
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(50,521)	4,252,303
Rënie/(rritje) në inventarë	-	979,510
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(198,318)	(13,441,680)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(3,130)	806,221
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(374,625)	(4,372,990)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera	-	530,000
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	-	530,000
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	-	(114,600)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	(114,600)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(374,625)	(3,957,591)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	553,494	4,510,742
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	1,010	343
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 179,879	553,494

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Gazeta Shqip sh.p.k me Nipt K61528011E është krijuar me vendim Gjykate të rrethit Tiranë nr. 35118 datë 02.03.2006.

Aktiviteti kryesor i saj është: Botimi, prodhimi, dhe shpërndarja e gazetave, revistave, librave dhe materialeve të tjera të lejuara me ligj.

Kapitali themeltar është: 100.000 lekë.

Ortak i vetëm i shoqërisë është Znj. Vjollca Hoxha.

Shoqëria "Gazeta Shqip" sh.p.k është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave Tiranë.
Adresa e shoqërisë është Rruga 5 Dëshmorët, Ndërtesë 5- katëshe Nr. 20 Tiranë

Numri I punonjësve në 31 dhjetor 2017 është 8.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
Euro/LEK	132,95	135,23
USD/LEK	111,1	128,17

3.2 Instrumentat financiarë

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e Aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%
Te tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdo rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare në bankë	167,075	547,155
Në lekë	84,069	530,191
Në monedhë të huaj	83,006	16,964
Mjete monetare në arkë	12,804	6,339
Totali	<u>179,879</u>	<u>553,494</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Klientë në lekë	15,489,430	16,305,540
Klientë në monedhë	488,383	496,729
Totali	<u>15,977,813</u>	<u>16,802,269</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Top Channel	1,080,000	-
Totali	<u>1,080,000</u>	<u>-</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Tatim mbi fitimin	639,081	639,081
Totali	<u>639,081</u>	<u>639,081</u>

8. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 :

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime të shtyra	206,339	403,064
Totali	<u>206,339</u>	<u>403,064</u>

SHQIP shpk

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Vlerat janë në Lek)

• 9. Aktive Afatgjata Materiale

	Mobilje dhe orendi	Komputera	Pajisje zyre	Mjete transporti	Të tjera	Totali
Kosto						
Gjendja më 1 janar 2016	2,922,862	4,715,854	39,533	7,278,234	175,000	15,131,483
Shtesa						
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	(4,044,434)	(85,000)	(4,129,434)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	2,922,862	4,715,854	39,533	3,233,800	90,000	11,002,049
Shtesa						
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	2,922,862	4,715,854	39,533	3,233,800	90,000	11,002,049
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2016	2,269,355	3,415,750	33,229	5,091,493	159,586	10,969,413
Amortizimi i vitit	130,701	325,027	1,260	423,717	3,083	883,788
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	(3,305,735)	(85,000)	(3,390,735)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	2,400,056	3,740,777	34,489	2,209,475	77,669	8,462,465
Amortizimi i vitit	104,561	243,770	1,008	204,866	2,466	556,671
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	2,504,617	3,984,547	35,497	2,414,341	80,135	9,019,136
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2016	522,806	975,077	5,044	1,024,325	12,331	2,539,584
Gjendja më 31 dhjetor 2017	418,245	731,307	4,036	819,459	9,865	1,982,912

10. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Llogari të pagueshme tregtare lek	32,801,447	30,159,756
Llogari të pagueshme tregtare euro	756,620	913,210
Totali	<u>33,558,067</u>	<u>31,072,966</u>

11. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura lek	135,000	8,346,860
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura euro	7,317,714	6,956,380
Totali	<u>7,452,714</u>	<u>15,303,240</u>

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	65,897	120,014
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	13,775	17,550
Totali	<u>79,672</u>	<u>137,564</u>

13. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Paga për tu paguar	806,219	806,219
Drejtoria Rajonale Sigurimeve Shoqërore	309	-
Të tjera detyrime	5,365,800	-
Totali	<u>6,169,210</u>	<u>806,219</u>

14. Kapitali themeltar

Kapitali i nënshkruar

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është në vlerën 100,000 lek.

Rezerva ligjore

Rezerva ligjore e shoqërisë është në vlerën 20,000 lek.

SHQIP shpk
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
 (Vlerat janë në Lek)

Fitime/Humbje e mbartur

Shuma prej (26,502,497) lekë përfaqëson humbjen e mbartur nga vitet e kaluara.

Humbja e vitit ushtrimor

Shuma prej (811,142) lekë përfaqëson humbjen e këtij viti ushtrimor

15. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga reklamat	6,277,408	23,853,915
Totali	<u><u>6,277,408</u></u>	<u><u>23,853,915</u></u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-ne	
Qarkullim i tatueshëm	6,277,408
Shuma e qarkullimit e korrektuar	6,277,408
Sipas Kontabilitetit	6,277,408
Diferenca	<u><u>-</u></u>

16. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzimet nga këmbimet valutore për marrëdhëniet tregtare	12,641	(88,325)
Të ardhurat nga këmbimet valutore për marrëdhëniet tregtare	(144,455)	200,483
Fitim/Humbje nga shitja e asetit	-	(31,482)
Totali	<u><u>(131,814)</u></u>	<u><u>80,676</u></u>

17. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave të shitura e cila detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Kostoja e mallrave të shitur	-	9,775,240
Shërbim fotografie dhe dizenjimi	-	180,000
Totali	<u><u>-</u></u>	<u><u>9,955,240</u></u>

18. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 :

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime qeraje	673,076	2,560,768
Blerje të ndryshme,kancelari etj	-	1,137,475
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	120,639	1,000,420
Komisione dhe honorare	-	965,796
Shpenzime të tjera	440,730	899,274
Publicitet , rekama	-	830,000
Sigurime	252,800	828,512
Karburant	-	589,200
Mirëmbajtje makine	109,560	-
Komisione dhe transporti	-	184,760
Abonime	-	190,727
Komisione bankare	84,202	96,835
Taksa të ndryshme	67,000	77,278
Totali	<u>1,748,007</u>	<u>9,361,048</u>

19. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për paga	4,282,232	10,509,496
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	633,144	1,682,397
Totali	<u>4,915,376</u>	<u>12,191,893</u>

20. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimi i amortizimit të asetëve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime amortizimi	556,671	883,787
Totali	<u>556,671</u>	<u>883,787</u>

21. Të ardhura të tjera

Të ardhura të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura të tjera	16	10,400,050
Totali	16	10,400,050

22. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime për interesa	(326)	(1,655)
Humbje nga këmbimet valutote	-	(1,139)
Totali	(326)	(2,794)

23. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
<i>Fitimi para tatimit</i>	(811,142)	1,938,511
Shpenzime të panjohura	-	1,350,510
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	(811,142)	3,289,021
Humbja fiskale e mbartur	(5,419,519)	(4,354,270)
Tatim fitimi 15%	-	-
Fitim/(Humbja) neto	(811,142)	1,938,511

24. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Top Channel	1,080,000	7,452,714	-	6,956,380
	1,080,000	7,452,714	-	6,956,380

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Top Channel	3,420,000	624,780	420,000	2,307,348
Valtelina	1,900,000	-	-	-
	<u>5,320,000</u>	<u>624,780</u>	<u>420,000</u>	<u>2,307,348</u>

25. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 Dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë Çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

26. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.